



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 20.05.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 18.05.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik me shifren 2107”” për aktivitetin: “Konkurs projektimi, konservimi dhe adaptimi i Ndertesës së ish-kadastrit në Prishtinë” dhe me numër të prokurimit: 616 -19-5638-423 nxjerr:

V E N D I M

REFUZOHET kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik”2107”, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Konkurs projektimi, konservimi dhe adaptimi i Ndertesës së ish-kadastrit në Prishtinë” dhe me numër të prokurimit: 616 -19-5638-5638-423 kundër *Njoftimit të Vendimit për vlerësimin teknik të AK –së*, të datës 14.05.2020, të publikuar në Platformën elektronike E Prokurimi të KRPP-së.

1. Vertetohet *Njoftimi i Vendimit* i publikuar me datë: 14.05.2020 dhe Autoriteti Kontraktues do të vazhdojë aktivitetin sipas të njëjtit.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik me shifren 8041-“Hidroing -DK” me datë 18.05.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Konkurs projektimi, konservimi dhe adaptimi i Ndertesës së ish-kadastrit në Prishtinë” dhe me numër të prokurimit: 616 -19-5638-423.

Autoriteti Kontraktues, edhe pse kërkesa nuk është dërguar nëpërmjet E prokurimit, me datë 20.05.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimet lidhur me vlerësim jo real të jurisë nuk mund të kontestojmë as parashtruesi i ankesës e as unë për arsyet në vijim:

-Juria eshte me perberje plotesisht profesionale dhe ka punuar kohe te gjate ne ekzaminim e projekteve te dorezuara nga kandidatet;

-Eshte paragjykues pretendimi per ndryshimin e poentimeve sipas jush te qellimshme pasi qe heren e pare aktiviteti eshte kthyer ne rivleresim sipas ankeses nga kandidati me shifren KA33,dhe arsyeja kryesore per te vendosur per rivleresim ka qene konstatimi se projekti i te njejtit nuk eshte vleresuar me seriozitet dhe poashtu ka pase indikacione,te cilat jane bazuar ne faktin se projekti i ranguar si i pari ka pase dallime te medha me projektet tjera.Se ky konstatim ka qene real eshte vertetuar nga vleresimi i jurise profesionale ne fazen e rivleresimit ku dallimet ne vleresime nuk jane te dukshme dhe natyrisht nuk do te ishte reale qe te dy jurite te kene vleresime identike. Poashtu duhet cekur se pas ankeses te kandidatit 8041 rivleresimin e ka bere nje juri tjetere dhe e njejta poashtu ne perberje profesionale e ne harmoni me kerkesat ligjore dhe qe poashtu eshte logjike qe te kete vleresim me ndryshe nga dy jurite paraprake. Per fund ua rikujtoj se sipas dispozitave ligjore dhe sipas Njoftimit per konkurs te projektimit(pika 4.4)rekomadimi i jurise eshte i obligueshem per Autoritetin Kontraktues dhe mund te dyshojme ne te njejtin vetem kur ka indikacione te forta si ne rastin e vleresimit te pare,ndersa lidhur me vleresimet specifike te koncept projekteve nuk mund te kontestojme asgje edhe nese ndonje dyshim eventual ekziston.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit duke u bazuar në konstatimet paraprake ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, pretenduesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit



Vendimi u dërgohet:

- Palës ankuese(nepermes Platformes elektronike);
- Njësisë së kërkesës;
- Departamentit të Prokurimit;dhe
- Anëtarëve të komisionit